



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

## **Shqiptim i Aktvendimit mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (KSC-CC-PR-2017-03)**

**28 qershor 2017**

### **Hyrje**

Shpall hapjen e seancës së shqiptimit të Aktvendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në çështjen e Referimit të Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës ('Ligji').

Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatësit e Plenares dhe publiku përgjithësisht janë informuar si duhet për datën dhe kohën e mbajtjes së kësaj seance.

Seancën plenare e cila nxori këtë Referim e kryesoi Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, të cilës në emër të panelit të Gjykatës Kushtetuese i uroj mirëseardhjen.

### **Procedura**

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e cila rregullon funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, u miratua prej gjykatësve të Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare ("Plenarja"), më 17 mars 2017 ('Rregullorja').

Më 27 mars 2017, Rregullorja iu referua Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('Gjykata') në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, për shqyrtimin e përputhshmërisë së saj me Kapitullin II, duke përfshirë nenin 55, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta').

Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata konstatoi se nga 208 rregulla, nëntë prej tyre ishin në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës dhe për një rregull nuk mund të deklaronte se ishte në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Referimi**

Më 29 maj 2017, Plenarja, me përjashtim të gjykatësve kushtetues, miratoi rregullat e rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ('Rregullat e Rishikuara').

Më 31 maj 2017, Rregullat e Rishikuara iu referuan Gjykatës në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit ('Referimi').

### **Historiku**

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese u formua në kuadër të Gjykatës Kushtetuese ekzistuese të Republikës së Kosovës dhe nëpërmjet shqyrtimit të kushtetutshmërisë së

Rregullores së Procedurës dhe të Provave ushtron kompetencë mbikëqyrëse mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe rrjedhimisht shërben si garantues shtesë i Kushtetutës.

Nga data e Referimit, Gjykata kishte 30 ditë për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës.

Më 8, 9, 23 dhe 24 qershor 2017, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese zhvilloi kuvendime në privatësi, në lidhje me Rregullat e Rishikuara.

Tani do të paraqes një përmbledhje të shkurtër të Aktvendimit që Gjykata miratoi sot, më 28 qershor 2017, dhe më pas do të lexoj dispozitat vendimore të tij.

Kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktvendimit dhe nuk është detyruese për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Një kopje e kësaj përmbledhjeje do të vihet në dispozicion në fund të kësaj seance.

Gjithashtu, teksti i plotë i Aktvendimit do të vihet në dispozicion në faqen e Dhomave të Specializuara në Internet.

## **Çështja**

Çështja që iu referua Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ngre pyetjen nëse Rregullat e Rishikuara janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kapitulli II i Kushtetutës trajton ‘Të Drejtat dhe Liritë Themelore’.

Fillimisht, Gjykata konstatoi se Referimi ishte i pranueshëm, sepse ishte bërë në përputhje me Ligjin.

Për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara, Gjykata u bazua në nenin 19(2) të Ligjit i cili kërkon që Rregullorja të pasqyrojë standardet më të larta të të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me synim garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

## **Vërejtje paraprake**

Gjykata vuri re se në përgjigje të Aktvendimit të Gjykatës të datës 26 prill 2017, Plenarja ka ndryshuar një numër dispozitash në një mënyrë të tillë që kufizon, në disa raste në masë mjaft të konsiderueshme, kompetencat e Prokurorit të Specializuar në lidhje me hetimin e veprave penale. Për shembull, Plenarja ka zvogëluar në masë të qenësishme kategorinë e personave në lidhje me të cilët mund të urdhërohen masa hetimore të posaçme dhe prej të cilëve mund të merren materiale të caktuara si prova.

Gjykata e vlerëson të nevojshme të theksojë se Aktgjykimi i datës 26 prill 2017 nuk kishte për qëllim të kufizonte në terma të përgjithshme kapacitetin hetimor të Prokurorit të Specializuar. Një gjë e tillë mund ta pengonte Prokurorin e Specializuar në ushtrimin e detyrimeve ligjore të tij. Faktikisht, konstatimet e Gjykatës kishin për synim të garantohet se në rastet kur ushtrimi i kompetencave hetimore të prokurorit cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, është e detyrueshme që ky ushtrim kompetencash t’u nënshtrohet garancive mbrojtëse të duhura, dhe aty ku është e domosdoshme, mbikëqyrjes

dhe kontrollit gjyqësor. Në këtë mënyrë arrihet drejtpeshimi i duhur midis interesave konkurrencte publike dhe private.

### **Konstatimet**

#### **Rregulla 19(3) – Mungesa e një gjykatësi**

Tani është e qartë se çdo gjykim para Dhomave të Specializuara të Kosovës do të jetë gjykim para një gjykate të themeluar me ligj, siç parashtrohet në nenin 31.2 të Kushtetutës.

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se rregulla 19(3) nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### **Rregulla 30 dhe rregulla 31 – Dispozita të përgjithshme dhe garanci minimale të përgjithshme**

Gjykata vëren se në rregullën 30, Plenarja ka përfshirë një kriter ombrellë që përmban një numër 'dispozitash të përgjithshme' të zbatueshme në lidhje me të gjitha hetimet dhe të cilat, ndër të tjera, i ngarkojnë Prokurorit të Specializuar detyrimin për të vepruar çdo herë në një mënyrë që është në përputhje me të drejtat themelore të njeriut.

Gjykata gjithashtu vëren se Plenarja ka miratuar një dispozitë të re - rregullën 31 – e cila mundëson disa 'garanci minimale të përgjithshme' të zbatueshme në lidhje me të gjitha masat hetimore që mund të cenojnë të drejtat themelore. Masa të tilla mund të autorizohen dhe kryhen vetëm kur janë 'të domosdoshme për hetimin', kur ndërhyrja e shkaktuar është 'proporcionale me qëllimin legjitim të hetimit' dhe kur 'nuk mohon thelbin e të drejtës së garantuar'.

Gjykata i mirëpret këto dispozita plotësuese të hartuara me synimin e garantimit të një mbrojtjeje edhe më të madhe të të drejtave themelore të njeriut dhe është e bindur se ato realizojnë kriteret e nevojshme kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se rregulla 30 dhe rregulla 31 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### **Rregulla 32 dhe rregulla 33 – Mbajtja, ruajtja, mbrojtja, kthimi dhe asgjësimi i materialit të mbledhur apo të sekuestruar**

Konstatimeve të Gjykatës në lidhje me pamjaftueshmërinë e garancive mbrojtëse në aspekte të ndryshme të identifikuar në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Plenarja u është përgjigjur duke miratuar dispozita 'gjithëpërfshirëse'. Rregulla 32 dhe rregulla 33 tani janë të zbatueshme në lidhje me materialet e mbledhura nga Prokurori i Specializuar nëpërmjet masave hetimore të posaçme, kontrollimit dhe sekuestrimit, si edhe mbledhjes së mostrave trupore.

Sidoqoftë, Gjykata konstaton se megjithëse ka parashtruar që materiale të tilla duhet të 'mbahen, ruhen dhe mbrohen në mënyrën e duhur', Plenarja nuk ka përcaktuar procedurat që mundësojnë mbajtjen, ruajtjen dhe mbrojtjen e duhur. Gjykata thekson se Plenarja ka zgjedhur që këto kompetenca t'ia delegojë një paneli.

Gjykata pranon se nevojitet kohë dhe ekspertizë e konsiderueshme për zhvillimin e procedurave të hollësishme në lidhje me, për shembull, si duhet të “mbahen në mënyrën e duhur” të dhënat celulare, regjistrimet e bisedave private apo materiale të tjera të ndjeshme.

Gjykata vlerëson se qasja e miratuar në Rregullat e Rishikuara, në praktikë mund të hasë në disa vështirësi dhe se, rrjedhimisht do të jenë të nevojshme udhëzime rregulluese konkrete për plotësimin e dispozitave ekzistuese, në veçanti në lidhje me aspekte teknike të tilla si ruajtja dhe mbajtja e llojeve të caktuara të të dhënave.

Gjithsesi, Gjykata konstaton se, duket se dispozitat e rregullës 32 dhe rregullës 33 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### **Rregulla 34 – Kushtet për marrjen e masave hetimore të posaçme**

Rregulla 34 saktëson llojin e veprave penale në lidhje me të cilat mund të përlegjen masa hetimore të posaçme ndër të cilat edhe urdhrat për përgjim. Gjithashtu, kjo rregull përkufizon kategoritë e personave në lidhje me të cilët mund të urdhërohen masa hetimore të posaçme.

Duke mbajtur parasysh detyrimin procedural të Prokurorit të Specializuar për hetimin e efektshëm të veprave penale të caktuara, mund të ngrihet një pyetje për sa i përket kategorisë së ngushtë të personave në lidhje me të cilët mund të urdhërohen masa hetimore të posaçme.

Gjithsesi, Gjykata konstaton se, duket se rregulla 34 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### **Rregulla 35 dhe rregulla 36 – Masa hetimore të posaçme të autorizuara prej një paneli, ose të urdhëruara prej Prokurorit të Specializuar**

Rregulla 35 parashtron masat hetimore të posaçme të autorizuara prej një paneli. Kjo rregull përcakton kufij të qartë në kohëzgjatjen e masave të tilla ndër të cilat mund të përfshihen vëzhgimi dhe përgjimi i fshehtë i komunikimeve, dhe i ngarkon panelit detyrimin për të përcaktuar periudhën kohore për të cilën jepet autorizimi. Po ashtu, kjo rregull përcakton garanci mbrojtëse të efektshme, si për shembull, një kufizim në periudhën fillestare gjatë të cilës mund të autorizohet një masë hetimore e posaçme, kushtet në bazë të të cilëve mund të zgjatet ajo periudhë, rrethanat në të cilat masat e autorizuara duhet të përfundojnë dhe kontrolli e mbikëqyrja gjyqësore e domosdoshme në zbatimin e masës.

Rregulla 36 parashtron masat hetimore të posaçme që mund të ndërmarrë Prokurori i Specializuar në rrethana të përcaktuara dhe të cilat i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor *ex post facto*.

Gjykata bindet se, duket se rregulla 35 dhe rregulla 36 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### **Rregulla 37 dhe rregulla 38 – Kontrollimi dhe sekuestrimi i autorizuar prej një paneli, ose urdhëruar prej Prokurorit të Specializuar**

Këto rregulla trajtojnë kontrollimet dhe sekuestrimet e autorizuara prej një paneli, ose të ndërmarra prej Prokurorit të Specializuar.

Gjykata konstaton se rregulla 37 parashtrohet një test më të fortë të domosdoshmërisë në lidhje me kushtet në përputhje me të cilat Prokurori i Specializuar bën kërkesë për autorizim prej panelit për kontrollim dhe sekuestrim.

Gjykata thekson se në interpretimin dhe vënien në zbatim të rregullës 37, ndërsa garanton që çfarëdo ndërhyrje të jetë 'në përputhje me ligjin', paneli gjithashtu duhet të ketë parasysh drejtpeshimin e duhur që duhet mbajtur midis të drejtave për integritet personal dhe privatësi nga njëra anë dhe domosdoshmërisë që Prokurori i Specializuar të kryejë një hetim të efektshëm.

Rregulla 38 kërkon që Prokurori i Specializuar të marrë parasysh domosdoshmërinë e operacionit të kontrollimit dhe sekuestrimit dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes përkatëse. Për më tepër, kjo rregull parashtrohet shqyrtim gjyqësor *ex post facto* për sa u përket aspekteve në lidhje me ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e masës. Gjykata është bindur se Plenarja i ka marrë parasysh konstatimet e Aktvendimit të 26 prillit 2017.

Gjykata konstaton se, duket se rregulla 37 dhe rregulla 38 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Rregulla 39 – Kryerja e kontrollimit dhe sekuestrimit**

Rregulla 39 trajton si kontrollimin me autorizim gjyqësor paraprak, po ashtu edhe kontrollimin dhe sekuestrimin me miratim gjyqësor *ex post facto*. Kjo rregull parashtrohet shkallën e nevojshme të saktësisë në procedurat që duhen zbatuar në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit.

Në kontekstin e kryerjes së kontrollimeve, Gjykata vëren se Rregullorja nuk përcakton konkretisht kontrollime të telekomanduara të pajisjeve të kompjuterizuara, synimi i të cilave është mbledhja e provave përkatëse, ose kopjimi i të dhënave. Autoritetet hetimore i konsiderojnë gjithmonë e më shumë kontrollimet e telekomanduara të pajisjeve të të dyshuarve si një instrument hetimor i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në luftën kundër veprave penale të rënda dhe komplekse. Duhet bërë dallim midis kontrollimeve të tilla të telekomanduara dhe kontrollimit të rëndomtë të diskut të palëvizshëm të kompjuterit të një të dyshuari dhe përgjimet e komunikimeve që kryhen përmes kompjuterit.

Ndërkohë që disa rregulla përmbajnë garanci mbrojtëse minimale në lidhje me aspektet e infiltrimit teknik, Gjykata i vlerëson kontrollimet e telekomanduara si një metodë me një shkallë të lartë ndërhyrëse që kërkon kushte më të rrepta për të garantuar që ndërhyrja përkatëse të mbetet brenda kufijve kushtetues të lejueshëm. Gjykata gjykon se Plenarja mund t'i marrë në shqyrtim çështje të tilla në të ardhmen. Gjithsesi, Gjykata konstaton se, duket se dispozitat ekzistuese të rregullës 39 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Rregulla 41 – Mbledhja e materialeve trupore për ekspertizë mjeko-ligjore**

Ndonëse vëren se Plenarja e ka zvogëluar në masë të konsiderueshme kategorinë e personave prej të cilëve mund të merren mostra trupore në bazë të një urdhri të gjykatës pa dhënien e pëlqimit, Gjykata gjithsesi konstaton se rregulla 41 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Rregulla 57(4) – Rishikimi dhe rivlerësimi i mbajtjes në paraburgim**

Gjykata arrin në përfundimin se rregulla 57(4) e cila përcakton lirimin e një personi brenda një shteti të tretë, nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Rregulla 137 – Dispozita të përgjithshme**

Plenarja ka fshirë një dispozitë në lidhje me të cilën në Aktvendimin e vet të 26 prillit 2017, Gjykata nuk mundi të nxirrte konstatim në lidhje me përputhshmërinë e saj me Kushtetutën.

Gjykata konfirmon se rregulla 137 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Rregulla 161 – Statusi i personit të shpallur të pafajshëm**

Rregulla 161 parashtrohet se kur një person i paraburgosur shpallet i pafajshëm, ai lirohet menjëherë, përveçse kur mbahet në paraburgim në mënyrë të ligjshme, ose vuan një dënim për vepra penale të ndryshme.

Gjykata konstaton se rregulla 161 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Dispozitat vendimore**

#### **PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, GJYKATA NJËZËRI**

1. *Deklaron* se Referimi është i pranueshëm;
2. *Vlerëson* se rregulla 19, rregulla 30, rregulla 31, rregulla 32, rregulla 33, rregulla 34, rregulla 35, rregulla 36, rregulla 37, rregulla 38, rregulla 39, rregulla 41, rregulla 57, rregulla 137 dhe rregulla 161, nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës;
3. *Vlerëson* se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës përputhet me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Data e hyrjes në fuqi**

Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Këtu përfundon seanca e pasdites të cilën rrjedhimisht e deklaroj të mbyllur.**

---

**Gjykatëse An Pauër-Ford**

**Kryesuese**